



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Politikën e Jashtme*

### RAPORT

#### MBI MBLEDHJEN E KOMISIONIT PËR POLITIKËN E JASHTME

#### PËR SHQYRTIMIN E

#### PROJEKTLIGJIT

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE  
ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË DHE TË  
TRANSPORTIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR ME QASJE PROGRAMATIKE  
ME SHUMË FAZA”**

#### I. HYRJE

Më 11 shtator 2019, Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

#### II. QËLLIMI DHE PERMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon marrjen e një kredie në shumën prej 17 600 000 eurosh në mbështetje të projektit për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza. Ky projekt është pjesë e fazës së parë të një programi të përbashkët rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili synon të lehtësojë arritjen e qëllimit të qeverive përkatëse të këtyre vendeve për të ulur kostot e tregtisë dhe rritjen e efikasitetit të transportit përmes angazhimit afatgjatë, adaptiv dhe të vazhdueshëm.

Programi përfshin dy faza të cilat do të zbatohen për një periudhë pesë vjet secili.

Faza 1 mbulon 3 nga vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipërinë, Maqedoninë Veriore dhe Serbinë), të konsideruara gati për zbatim, dhe do të përfshijë një kombinim të investimeve, asistencës teknike dhe reformave rregullatore dhe institucionale.

Faza 2 e programit përfshin 3 vendet e tjera të rajonit: Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi.

Rezultatet e pritshme me realizimin e këtij projekti, të cilat janë të lidhura me objektivat e zhvillimit të tij gjatë fazës së parë, janë reduktimi i kostove të tregtisë dhe rritja e efikasitetit të transportit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Projektligji është planifikuar për t'u implementuar gjatë periudhës 2019 – 2025.

### **III. DISKUTIMI NË KOMISION**

Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, z. Erjon Luçi, informoi deputetët për qëllimin, vlerën dhe natyrën e marrëveshjes si dhe iu përgjigj pyetjeve dhe vërejtjeve të deputetëve veçanërisht atyre lidhur me karakterin analitik politik të relacioneve.

Relatori z. Ervin Bushati u shpreh se në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Kryetarja e Komisionit Kodheli vlerësoi paraqitjet e bëra dhe falënderoi pjesëmarrësit për ndërhyrjet. Me tej ajo ftoi Komisionin të votonte projekt-ligjin.

**Në përfundim të diskutimeve,** Komisioni miratoi me unanimitet projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

**RELATORI**

**ERVIN BUSHATI**

**KRYETARE**

**MIMI KODHELI**